

Prishtinë: 15/03/2007

Kodi i ZRRE: D_40_2007

Duke marrë parasysh:

1. Dispozitat e Ligjit Nr. 2004/9 “Mbi Rregullatorin e Energjisë”, dhe
2. Kapitullin e dytë (2) të Furnizimit me ngrohje të “Rregullit mbi Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji”.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji, në seancën e mbajtur më 15 Mars 2007 ka nxjerrë këtë:

VENDIM

Për aprovimin e kërkesës për “Çmimoren e shërbimeve për intervenime në rrjetin sekondar të instalimeve të ngrohjes qendrore” për N.Q. ”TERMOKOS” dhe N.Q. ”GJAKOVA”.

1. Në Shkurt të Vitit 2007 N.Q. “TERMOKOS” dhe N.Q. ”GJAKOVA” ka ushtruar kërkesën për miratimin e “Çmimoreve të shërbimeve për intervenime në rrjetin sekondar të instalimeve të ngrohjes qendrore”.
2. ZRRE-ja ka shqyrtuar kërkesën e ngrohtorës N.Q. “TERMOKOS” dhe N.Q. ”GJAKOVA” me datë 8 Mars 2007, ku janë harmonizuar përlllogaritja e çmimeve në intervenimet në rrjetin sekondar për ngrohje, sipas arsyetimeve të paraqitura nga ngrohtoret.
3. Kalkulimi i çmimeve për shërbimet e kryera kanë qenë të arsyeshme për të dy ngrohtoret për përshkrimin dhe llojin e shërbimeve të kryera në rrjetin sekondar për sektorin e amvisërisë.
4. ZRRE ka shqyrtuar dhe miratuar kërkesën e N.Q. “TERMOKOS” dhe N.Q. ”GJAKOVA” “Çmimoren e shërbimeve për intervenime në rrjetin sekondar të instalimeve të ngrohjes qendrore”
5. Rrjeti sekondar nënkuptohet rrjeti i Ngrohjes qendrore që i shërben një konsumatori ose grupi të konsumatorëve nga pika dalëse e nënstationit
6. Ky Vendim nxirret në tri gjuhë: shqip, serbisht dhe anglisht. Në rast të mospërputhjes midis versioneve të ndryshme, do të sundojë versioni në gjuhën shqipe.

7. Pala e pakënaqur, mund të paraqesë ankesë kundër këtij Vendimi në gjykatën e juridiksionit përkatës, brenda 14 ditësh nga data e miratimit ose datës së publikimit të vendimit në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.
8. Ky Vendim hyn në fuqi datën e lëshimit ose datën e publikimit në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së

Bashkëngjitur do të gjeni:

1. Çmimoren për rrjetin sekondar

Bordi i ZRRE-së

Ali Hamiti
Kryesues

Merita Kostari
Anëtare

Theranda Beqiri
Anëtare

Naim Bejtullahu
Anëtar

Nysret Avdiu
Anëtar
